



Pranuar / Dorezuar Punimjen / Primalo Received / Delivered	03.11.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SARISTEK	6689/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.38/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.919/2020 të datës 01.09.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.38/2020 të datës 18.02.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit-Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.38/2020 e datës 18.02.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Detyrohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 03.12.2019 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat materiale.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] më datë 18.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 390/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, si dhe për shkak të mos kompensimit të 50% të pagës së ndalur sipas Vendimit për pezullim 01nr.118-66444 të datës 21.03.2016 për periudhën kohore nga data 21.03.2016 deri më datë 10.03.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.02.2020 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit nuk ka dorëzuar përgjigje në ankesë duke përfshirë edhe mos dorëzimi e shkresave lidhur me çështjen ankimore.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokolli 899/2020 të datës 15.05.2020 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative sipas padisë së ankuesit, më datë 01.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.919/2020 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e paditësit tani ankuesit të datës 18.02.2020. Pas pranimit të aktgjykimit A.nr.919/2020 të datës 01.09.2022, Këshilli me datë 11.10.2022 ka përcjell serish të organi i punimit kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa ky i fundit me datë 18.10.2022 ka dërguar provat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 390/2020 të datës 18.02.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimin me numër 01nr.118-66444 të datës 21.03.2016 për pezullim parandalues të ankuesit; Kërkesën e datës 03.12.2019 e parashtruar nga ankuesi tek Kryetari i Komunës së Prishtinës; Ankesën e datës 08.01.2020 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës; Aktgjykimin PP.nr.376/12 i datës 21.10.2016 i Gjykatës Themelore në Prisen; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 445/2020 të datës 25.02.2020; Fletë kthesën e datës 26.02.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.10.2022 (përmes emailit); Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me numër protokolli 6290/2022 të datës 18.10.2022; Akt Emërimit me numër 01-112-535 të datës 11.03.2013 të ankuesit; Kërkesën me Nr.800 të datës 07.11.2017 nga Avokatura Publikë e Komunës së Prishtinës për Gjykatën Themelore në Prizren; Vendimin me numër 01.nr.01-119-205938 i datës 01.09.2014; Kartela e nëpunësit civil për ankuesin për vitin 2016, 2017 dhe 2018; Vendimin me numër 14-118/02-49888/18 të datës 01.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit me rastin e pensionimit; Njoftimin e datës 15.05.2020 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.919/2020 të datës 01.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në Aktgjykimin A.nr.919/2020 të datës 01.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale, rrjedhimisht sipas Akt-it të Emërimit me numër 01-112-535 të datës 11.03.2013 rezulton së ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Gjeodezi*. I njëjti me Vendimin 01Nr.118-66444 të datës 21.03.2016 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës, për arsye se

ndaj tij ishte konfirmuar Aktakuza PP:376.12, Hep: 273/12 për veprën penale të ngritur nga Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Me Vendimin numër 14-118/02-49888/18 të datës 01.03.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 10.03.2018.


Në bazë të Aktgjykimit me numër të lëndës PP.nr.376/12 të datës 21.10.2016 të Gjykatës Themelore në Prizren, i plotfuqishëm nga data 16.09.2018, është refuzuar akuza për ankuesin në kuptim të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar dhe mashtrim në bashkëkryerje sipas pikës 2 dhe 5 të Aktakuzës, ndërsa është liruar nga akuza për vepër penale krim i organizuar sipas pikës 11 të Aktakuzës.

Ankuesi më datë 03.12.2019 kishte parashtruar kërkesë me numër protokolli 14-117/01-0294805/19 drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës lidhur me kompensimin e 50% të pagës, nga dita e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në ditën e pensionimit. Pasi që ankuesi nuk kishte pranuar përgjigje nga Kryetari i Komunës lidhur me kërkesën e tij të datës 03.12.2019, i njëjti më datë 08.01.2020 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës. Pas heshtjes edhe të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin së Komuna e Prishtinës në kundërshtim me Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil nuk ka bërë kompensimin e 50% të pagës, pasi që i njëjti është liruar-refuzuar nga aktakuza. Kërkon që Këshilli të aprovojë si të bazuar ankesën dhe të obligoj Komunën e Prishtinës që të bëjë kompensimin e 50% të pagës nga data 21.03.2016 deri më datë 10.03.2018.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ju referua nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi"*, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke marrë parasysh së ankuesi me Aktgjykimin të plotfuqishëm gjyqësor nuk është shpallur fajtor lidhur me veprat penale sipas aktakuzës për shkak të cilës ankuesi ishte pezulluar nga puna, në vlerësimin e Kolegjit, organi i punësimit përkundër kërkesës së ankuesit të datës 03.12.2019 si dhe ankesës së datës 03.12.2019 nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin sipas dispozitave ligjore të lartë cekura.

Nisur nga faktet si me lartë, Kolegji në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë konstaton së organet publike duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Andaj, theksuar si me sipër Kolegji vlerëson që organi i punësimit gjegjësisht Kryetari i Komunës së Prishtinës është i detyruar që të shqyrtoj kërkesën e ankueses së datës 03.12.2019 dhe të nxjerr vendim në pajtim me dispozitat materiale, kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën



paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.38/2020

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

